

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7936  
E enjte, 21 nëntor 2024  
Çmimi 0.50

A do të sjellë 2025-ta një ndryshim të madh për udhëtarët në BE? | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## RAMA: DO TË HEDHIM NË DISKUTIM MASAT PËR MBYLLJEN E TIKTOK-ut DHE SNAPCHAT-it NË SHQIPËRI

| FAQE 4-5



Disa ditë pas vrasjes së një nxënësi 14-vjeçar, Qeveria e Shqipërisë ka paraqitur për diskutim dy propozime që

synojnë ta frenojnë ndikimin e rrjeteve sociale TikTok dhe Snapchat te fëmijët. Pas mbledhjes së qeverisë,

kryeministri shqiptar Edi Rama tha se vendimi do të merret pas konsultimit me mësues dhe prindër

**POLICËT E RINJ TË KOSOVËS TRAJNOHEN TRE MUAJ, MË SË PAKU NË RAJON** F. 5



**MË PAK SE 20 PËR QIND E PRONAVE NË KOSOVË JANË TË REGJISTRUARA NË EMËR TË GRAVE** F. 8



### AKTUALE



**BIDENI APROVON FURNIZIMIN E UKRAINËS ME MINA KUNDËR KËMBËSORISË** F. 2

**DEBATI PEÇI - PACOLLI, AKUZA DHE KUNDËRAKUZA PËR OFERTAT POLITIKE DHE KORRUPTIVE** F. 6

**KURTI VIZITON NJËRËN NGA DEPOT KU JANË VENDOSUR FURNIZIMET E FUNDIT ME ARMATIM TË USHTRISË** F. 6

### EKONOMI



**GUVERNATORI ISMAILI TAKON DREJTUES TË LARTË TË FMN-së, BB-SË DHE GUVERNATORË TË BANKAVE QENDRORE EVROPIANE** F. 8

**ODA AMERIKANE MIRËPRET KTHIMIN PËR RISHOYRTIM TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT** F. 8

### SPORT



**VENDOS UEFA, KOSOVA E HUMB NDESHJEN ME RUMANINË ME REZULTAT ZYRTAR 3:0** F. 10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Bideni aprovon furnizimin e Ukrainës me mina kundër këmbësorisë

UASHINGTON, 20 NËNTOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, e ka miratuar furnizimin e Ukrainës me mina kundër këmbësorisë, tha një zyrtar amerikan për "Reuters". Ky shihet si një hap që mund t'i ndihmojë Ukrainës ta ndalë përparimin e forcave ruse në lindje të vendit, posaçërisht nëse minat përdoren bashkë me municionet e tjera nga Shtetet e Bashkuara. Shtetet e Bashkuara presin që Ukraina t'i përdorë minat në tokën e vet, edhe pse ka kërkuar që ato të mos përdoren në pjesët e banuara me civilë, tha zyrtari. "Washington Post" raportoi i pari për vendimin e Bidenit.

Shtetet e Bashkuara e kanë furnizuar Ukrainën me mina kundërtanke gjatë gjithë luftës së saj me Rusinë, por shtimi i minave kundër këmbësorisë ka për qëllim frenimin e përparimit të këmbësorisë ruse, theksoi zyrtari, i cili foli në kushte anonimiteti. Minat amerikane dallojnë nga ato të Rusisë, sepse ato janë të "paqëndrueshme" dhe bëhen të padobishme pas një kohe, tha zyrtari. Atyre u nevojitet bateri për të shpërthyer dhe nuk mund të shpërthejë pasi t'u ketë mbaruar bateri. Të martën Ukraina i përdori raketat amerikane me rreze të gjatë, ATACMS, për të kryer sulme në tokën ruse, duke e shfrytëzuar lejen që



administrata në largim e presidentit amerikan Joe Biden ia dha në ditën e 1 000 të

luftës. Moska tha se përdorimi i ATACMS-ve, raketat me rrezen

më të gjatë që Uashingtoni e ka furnizuar deri më tani Ukrainën, është shenjë e qartë se Perëndimi dëshiron ta përshkallëzojë konfliktin. Të martën presidenti rus Vladimir Putin e uli pragun për përdorimin e armëve bërthamore si përgjigje ndaj një game më të gjerë të sulmeve konvencionale. Rusia ka muaj që e paralajmëron Perëndimin se nëse Uashingtoni e lejon Ukrainën të hedhë raketa amerikane, britanike dhe franceze thellë brenda Rusisë, atëherë Moskë do t'i konsiderojë këto vende anëtare të NATO-s si të përfshira drejtpërdrejt në luftën në Ukrainë.

## HRW: Irani po e përdor ekzekutimin për t'i shtypur pakicat

NJU-JORK, 20 NËNTOR - Autoritetet iraniane janë duke e përdorur ekzekutimet si "mjet frike", posaçërisht kundër pakicave, kundërshtarëve dhe shtetasve të huaj, tha të mërkurën organizata për të drejtat e njeriut, Human Rights Watch (HRW). Kjo organizatë theksoi një rritje rishtazi të dënimeve kapitale kundër këtyre grupeve, duke nënvizuar se ka shkelje të pakontrolluar të proceseve gjyqësore në dhënien e dënimeve. Sipas Grupit Iranian për të Drejtat e Njeriut, në 10 muajt e parë të këtij viti janë ekzekutuar të paktën 651 njerëz në Iran - prej të cilëve 166 vetëm në tetor. HRW-ja e përmendi rastin e të burgosurës politike kurde, Varisheh Moradi, e cila u dënua me vdekje nga Gjykata



Revolucionare e Iranit në Teheran, më 10 nëntor, nën akuzat për "kryengritje të armatosur kundër shtetit". Moradi, anëtare e Shoqatës së Grave të Lira të Kurdistanit Lindor, u arrestua në qytetin Sanandaj në Provincën e Kurdistanit në gusht të vitit të kaluar dhe u mbajt për pesë

muaj në izolim në burgun famëkeq Evin, ku u torturua. Familja e saj nuk është lejuar ta vizitojë që nga maji, sipas grupit. Moradi nuk iu lejua të mbrohej dhe gjyqtari nuk lejoi që avokatët e saj ta mbronin atë në gjykatë, raportoi Rrjeti i të Drejtave të Njeriut në Kurdistan.

"Autoritetet iraniane e përdorin dënimin me vdekje si mjet frike, duke synuar veçanërisht pakicat etnike dhe disidentët politikë pas gjyimeve të padrejta", tha Nahid Naghshbandi nga HRW-ja. "Kjo taktikë brutale ka për qëllim ta shtypë çdo kundërshtim ndaj qeverisë autokratike përmes frikësimit", shtoi ajo. Pesë burra të tjerë kurdë janë dënuar me vdekje javët e fundit nën akuzë për "spiunazh për Izraelin", tha HRW. Katër të burgosur arabë nga Ahvazi, në Provincën Khuzestan, janë në rrezik të ekzekutimit të menjëhershëm, pasi janë dënuar me vdekje nga një gjykatë revolucionare, së bashku me dy individë të tjerë, për përfshirjen e dyshuar në vrasjet e dy anëtarëve të Basijit, një oficeri të forcave të rendit dhe një ushtari.

Katër të burgosurit - Ali Majdam, Moein Khonafri, Mohammadreza Moghadam dhe Adnan Gheibshavi (Musavi) - u arrestuan në vitet 2017 dhe 2018, sipas grupeve për të drejtat e njeriut. Në veçanti shtetasit afganë në Iran kanë qenë në shënjestër të dënimeve me vdekje, theksoi HRW, duke shtuar se, sipas grupeve për të drejtat e njeriut, të paktën 49 shtetas afganë janë ekzekutuar në Iran këtë vit, 13 vetëm gjatë muajit të kaluar. Mai Sato, raportuesja speciale e Kombeve të Bashkuara për situatën e të drejtave të njeriut në Iran, gjithashtu ka shprehur shqetësimin e saj për rritjen "alarmante" të numrit të ekzekutimeve. "Vetëm në gusht 2024, të paktën 93 persona u ekzekutuan, gati gjysma në lidhje me shkeljet e ligjit për drogën", tha Sato më 1 nëntor.

## Kroacia mban zgjedhjet presidenciale më 29 dhjetor

ZAGREB, 20 NËNTOR - Kroacia do t'i mbajë zgjedhjet presidenciale më 29 dhjetor, ka thënë kryeministri Andrej Plenković të martën. Emri i fituesit pritet të dihet vetëm pas një balotazhi dy javë më vonë përtej datës së zgjedhjeve. Qeveria do ta zyrtarizojë datën të enjten, ka thënë kryeministri para gazetarëve. Presidenti aktual Zoran Milanović, mandati i të cilit skadon në shkurt, synon një mandat të dytë dhe aktualisht prin në sondazhe.

Kundërshtari i tij më i madh është kandidati i partisë konservatore në pushtet HDZ, Dragan Primorac, tregojnë sondazhet. Asnjëri nuk pritet të fitojë në raundin e parë, sipas sondazheve, dhe gjithçka pritet të finalizohet në raundin e dytë që mund të mbahet më 12 janar. Milanović i ka fituar zgjedhjet presidenciale në janar të vitit 2020 si kandidat i partisë kryesore opozitare të Social-Demokratëve. Ndonëse ka çuar përpara politikë të "Kroacisë normale" si



demokrati liberale, në vitet e fundit ai ka adoptuar retorikë populiste. Presidenti 58-vjeçar ka dënuar qëndrimin e Bashkimit Evropian për luftën e Rusisë kundër Ukrainës, duke nxitur kryeministrin e shtetit që ta akuzojë atë për "qëndrim pro-ruse". Ndonëse pozita e presidentit është kryesisht ceremoniale, presidenti përfaqëson Kroacinë në skenën botërore, koordinon bashkë me qeverinë politikën e jashtme dhe është në krye të forcave të armatosura.

## Rama: Do të hedhim në diskutim masat për mbylljen e TikTok-ut dhe Snapchat-it në Shqipëri

Disa ditë pas vrasjes së një nxënësi 14-vjeçar, Qeveria e Shqipërisë ka paraqitur për diskutim dy propozime që synojnë ta frenojnë ndikimin e rrjeteve sociale TikTok dhe Snapchat te fëmijët. Pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri shqiptar Edi Rama tha se vendimi do të merret pas konsultimit me mësues dhe prindër

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

TIRANË, 20 NËNTOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, pas mbledhjes së qeverisë, tha për mediet se do të hedhë në diskutim mbylljen e plotë të rrjeteve sociale TikTok dhe Snapchat. Ai theksoi se qeveria është në dilemë për të vendosur filtra apo të marrë masa drastike për mbylljen e rrjeteve sociale që janë kthyer në burim dhune. "Prej tre ditësh i madh dhe i vogël është tronditur nga vrasja makabër e një nxënësi 14-vjeçar me thikë nga një adoleshent tjetër. E gjithë dinamika e tragjedisë nxjerr në pah kërcënimin permanent me të cilin jetojnë të gjithë familjet që rrisin fëmijë në botën e sotme ku rrjetet sociale dhe posaçërisht TikTok-u apo Snapchat-i thithin përditë në labirintet e tyre fëmijët tanë qysh në moshat më të vogla. Autoritetit i prindërve dhe i mësuesve, si dhe të gjitha përpjekjet

tona në familje apo në shkollë për edukimin e fëmijëve, sfidohen orë e çast nga bota paralele e këtyre rrjeteve ku nuk ka asnjë filtër, asnjë mbrojtje, asnjë stimul pozitiv në mbështetje të këtyre përpjekjeve dhe ku jo vetëm edukimi, por deri dhe shëndeti mendor i më të vegjëlve, i adoleshentëve, vihen seriozisht në pikëpyetje", ka thënë Rama.

Ai ka shtuar se këto janë të vërteta të thjeshta me të cilat nuk është e vështirë të bien të gjithë dakord si prindër apo si qytetarë - dëshmitarë të shoqërisë të kohës të botës së sotme ku, sipas tij, garantimi i sigurisë së fëmijëve është përparësia e përparësive tona. Megjithatë Rama thotë se nuk janë po kaq të thjeshta përgjigjet e duhura në këto kushte, kaq sfiduese kur shumë shtete po përipien të vendosin filtra mbrojtës, por ende pa asnjë rezultat domethënës. "Ne si qeveri jemi angazhuar prej kohësh në hulumtimin e kësaj



problematike duke ndjekur hap pas hapi se çfarë bëjnë vendet e tjera, por edhe në kërkimin e zgjidhjeve të mundshme për ta ulur këtë presion gjithnjë e më të frikshëm. Faktikisht janë ndërmarrë iniciativa të ngjashme që nga Australia ku aktualisht po tentohet ndalimi i aksesit në rrjetet sociale të të gjithë fëmijëve deri në 16 vjeç, deri te Franca e cila po diskuton vendosjen si kusht të aprovimit të prindërve për hapjen e një llogarie online nën 15 vjeç apo Spanja ku fillimisht u vendos që fëmijët deri 14 vjeç të mos lejohen të hapin llogari online

dhe së fundmi ky kufi është rritur në 16 vjeç. Po përtej këtyre përpjekjeve dhe debateve lidhur me këto nisma, problemi ende i hapur mbetet mungesa e një sistemi të zbatimit të tyre si rezultat i vështirësisë në aspektin teknik që lidhet me disa faktorë të cilët nuk është vendi t'i shtjellojmë këtu sot", ka thënë Rama, duke shtuar se tani dilema e tyre si qeveri është nëse duhet të provojnë në drejtim të vendosjes së filtrave kur, në fakt, nga të gjitha eksperiencat e deritanishme në Evropë apo përtej Evropës, mësojmë se efektiviteti i tyre është

ende shumë i ulët. "Ndërkohë që stimujt e dhunës dhe rastet e bullizmit në botën online të fëmijëve dhe të adoleshentëve, vetëm rriten apo të ndërmarrim një masë drastike për mbylljen e plotë të Tik-Tok-ut e pse jo, të Snapchat-it në territorin e Republikës së Shqipërisë", ka deklaruar Rama. Vrasja e 14-vjeçarit, nxënësi i shkollës 9-vjeçare "Fan Noli" në qendër të Tiranës, tronditi Shqipërinë të hënën, më 18 nëntor. Vrasja me thikë u krye nga një tjetër nxënësi i kësaj shkolle i cili është arrestuar.

## A do të sjellë 2025-ta një ndryshim të madh për udhëtarët në BE?

PRISHINË, 20 NËNTOR - Fundjavën e kaluar mund të zbulohet Sistemi i ri i Hyrje/Daljes në Bashkimin Evropian (EES).

Ky sistem i ri nënkupton se kur një shtetas jo i BE-së hyn në cilindo prej 29 vendeve të zonës së lëvizjes së lirë, Schengen, ai duhet ta regjistrojë emrin e plotë dhe kombësinë, t'i japë gjurmët e gishtërinjve dhe të fotografohet - sipas të gjitha gjasave - në një kabinë me vetëshërbim.

Sistemi u miratua nga BE-ja në fund të vitit 2017 dhe do ta heqë vulosjen manuale të pasaportave jo të BE-së, përkatësisht do ta zëvendësojë sistemin e vjetër me një bazë të madhe elektronike të të dhënave.

Sipas Komisionit Evropian, sistemi i ri do të ndihmojë në parandalimin e migrimit të parregullt, do t'i ndihmojë shtetasit e vendeve të treta të udhëtojnë më lehtë, do t'i identifikojë përpjekjet për ta tejkaluar kohën e lejuar të qëndrimit, ose për fshehje të identitetit. Megjithatë, ai nuk u funksionalizua - as më 10 nëntor siç ishte planifikuar, e as në datën rezervë, më 17 nëntor.

Por, për të qenë më të saktë, datat nuk u përcaktuan kurrë me vendosmëri.

Flitej që kjo mund të ndodhte dikur



edhe në tremujorin e fundit të këtij viti dhe nuk ishte hera e parë që u shty.

As në vitet 2022 dhe 2023, sistemi i ri nuk ishte gati.

Dhe, shtrohet pyetja: përse këto vonesa të vazhdueshme?

Një përgjigje është se bëhet fjalë për një ndërmarrje masive të teknologjisë informative dhe, në këtë shkallë, ajo nuk ka qenë e testuar më parë.

Kur në tetor ministrat e Brendshëm

të BE-së ranë dakord se prezantimi në nëntor nuk është i mundur, ishin Franca, Gjermania dhe Holanda - tri shtete anëtare me shumë pika të hyrjes - që e frenuan.

Ministria e Brendshme gjermane tha atëkohë se sistemit qendror kompjuterik, që do ta mbështeste sistemin e ri, e që mbikëqyret nga agjencia e BE-së, eu-LISA, i mungon "stabiliteti dhe funksionaliteti i nevojshëm".

Një diplomat i BE-së, i cili ka dijeni

për çështjen, u shpreh edhe më ashpër, duke i thënë Radios Evropa e Lirë se i gjithë sistemi është "i dobët" dhe se nuk është testuar përpara nisjes zyrtare.

Ndërsa agjencia e BE-së, eu-LISA, tha se të gjitha vendet anëtare të BE-së janë gati teknikisht, ka frikë se sistemi i ri do të krijojë kaos në qendrat kryesore të kontinentit, duke goditur kështu biznesin dhe turizmin me radhë masive kufitare.

Një nga problemet është se BE-ja donte ta lansonte sistemin kudo në të njëjtën kohë. Por, në Bruksel tani flitet për një qasje me faza, që do të thotë se rregulloret e miratuara tashmë, duhet të ndryshohen.

Kjo mund të bëhet nëse ka vullnet politik, i cili duket se ekziston, por i takon Komisionit Evropian të përcaktojë se çfarë do të thotë saktësisht qasja me faza.

Ndërkohë, shumë qendra dhe pika kufitare do të vazhdojnë të përgatiten për lansimin eventual të sistemit në vitin 2025, duke shtuar më shumë barriera automatike dhe kabina të vetëshërbimit, si dhe duke trajnuar stafin dhe rojet kufitare. Pasi të funksionalizohet ky sistem, qytetarët jashtë BE-së i pret edhe një gjë tjetër.

Plani është që rreth gjashtë muaj më

vonë, të procedohet me Sistemin Evropian të Informacionit dhe Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS).

Ky do t'i mbulojë të gjithë udhëtarët e përjashtuar nga vizat me BE-në, përfshirë shtetasit e SHBA-së dhe Britanisë, por edhe ukrainasit, gjeorgjianët dhe moldavët, si dhe qytetarët e shteteve të Ballkanit Perëndimor jashtë BE-së.

Vlen të theksohet se marrja e miratimit nga ETIAS-i nuk është vizë dhe nuk garanton hyrjen.

Autorizimi, i vlefshëm për tre vjet do të kushtojë 7 euro dhe do të duhet të plotësohet nga të gjithë personat e moshës 18 deri në 70 vjeç.

Përjashtime do të mund të bëjnë individët me viza dhe leje qëndrimi, refugjatët, mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe pasagjerët transit në aeroporte.

Për ETIAS-in, BE-ja ra dakord në vitin 2018 dhe, sikurse EES-ja, ai është pjesë e përpjekjeve për ta bërë zonën Schengen më të fuqishme dhe më të kontrolluar.

Me imigracionin sërish në krye të agjendës politike në të gjithë bllokun, ka të ngjarë që të ketë një shtytje të fortë nga disa shtete anëtare, si dhe nga vetë Komisioni Evropian për t'i funksionalizuar të dyja sistemet në vitin 2025.



# Policët e rinj të Kosovës trajnohen tre muaj, më së paku në rajon

**Policia e Kosovës konfirmon se ka më shumë se një vit që ka ndryshuar planin e trajnimit profesional të policëve të rinj, të cilën ekspertët e sigurisë e përshkruajnë shqetësuese**

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Për përdorimin e armëve të gjata, vetëm tri ditë stërvitje! Kaq thotë se ka kaluar Ekremi, i cili është pjesëtar i gjeneratës së 59 të Policisë së Kosovës. “Kjo është shumë pak për t’u aftësuar siç duhet”, sipas tij. Ekremi - identiteti i plotë i të cilit është i njohur për redaksinë e Radios Evropa e Lirë - ka kryer një pjesë të trajnimit në fillim të këtij viti. “Një ditë kemi mësuar vetëm literaturë, të nesërmen kemi demonstruar dhe pastaj kemi dalë në gjuajtje. Personalisht, mendoj se duhet të ketë trajnime më të gjata - edhe jashtë plan-programit në akademi”, thotë ai.

gjata. Ndonëse për të thotë se ato kanë qenë të mjaftueshme, ai shton se ka vënë re se shumë kolegë të tij nuk kanë arritur të mësojnë shumë. Policia e Kosovës konfirmon se ka më shumë se një vit që ka ndryshuar planin e trajnimit profesional të policëve të rinj - nga gjashtë muaj sa ka qenë më herët, kohëzgjatja e tij është bërë tre muaj - gjë të cilën ekspertët e sigurisë e përshkruajnë si shqetësuese. Në Inspektoratin Policor të Kosovës thonë se ka shtim të lehtë të ankesave për policët këtë vit. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në anën tjetër, thotë se ka bashkëpunuar vazhdimisht me Policinë, për të siguruar respektimin e standardeve

ndërkombëtare, të cilat përfshijnë edhe shkurtimin e programeve të trajnimit.

**Përse është shkurtuar kohëzgjatja e trajnimit?**

Policia e Kosovës thotë se vendimi është marrë në përshtatje me “nevojat dhe kërkesat e saj operative”, por nuk ofron më shumë detaje rreth tyre. “Modulet e parapara që të zhvillohen me kadetë policorë, janë fuzionuar dhe janë inkorporuar temat gjithëpërfshirëse, me ç’rast plan-programi i trajnimit profesional ‘zyrtar policor’ zhvillohet në kohëzgjatje prej 12 javësh, apo tre muajsh”, thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës për Radion Evropa e Lirë. Në OSBE - misionin që me programe të ndryshme e ka mbështetur Policinë që nga themelimi i saj në vitin 1999 - thonë se disa prej arsyeve të këtij vendimi lidhen me “mungesat e përkohshme të personelit”. “Marrë parasysh natyrën e ndryshimit, misioni është i gatshëm ta mbështesë Policinë e Kosovës derisa vazhdon t’i riorganizojë

prioritetet e saj të stafit dhe operacionale”, thuhet në përgjigjen e OSBE-së. Policia e Kosovës aktualisht, ka 9 089 pjesëtarë, përfshirë edhe gjeneratën e 61-të, e cila ka dalë muajin e kaluar. Burime brenda Policisë bëjnë me dije për Radion Evropa e Lirë se me strategjinë e re të këtij institucioni, parashihet që numri i forcave policore të rritet së shpejti në mbi 10 300. Policët e rinj trajnohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të vendit. Kjo akademi është akredituar nga Asociacioni Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimeve për Zbatim të Ligjit (IADLEST) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Asnjëri prej dy institucioneve të lartpërmendura nuk iu përgjigj kërkesës së Radios Evropa e Lirë për të komentuar zvogëlimin e kohëzgjatjes së trajnimit të policëve të rinj. Në Policinë e Kosovës shprehen të bindur se trajnimi u mundëson kadetëve policorë të pajisen me njohuri të mjaftueshme për rregullat e

sigurisë, si dhe për manipulimin me armët që përdoren nga ky institucion. “Trajnimi për armë zjarri zgjat dy javë. Në të përfshihen armët e shkurtra dhe të gjata, sipas Ligjit për armë”, thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës. “Kadetët policorë i nënshtrohen testit me shkrim dhe testimit praktik në gjuajtje” dhe më pas “vlerësohen nga stafi trajnues në skenarë të ndryshëm”, thuhet po ashtu. Për njohësit e sistemit të sigurisë, trajnimi prej tre muajsh i policëve të rinj është larg të qenët i mjaftueshëm. Kjo situatë, sipas tyre, është duke shkaktuar edhe probleme në terren. “Nuk besoj se jemi në ndonjë situatë emergjente për t’i përfunduar këto trajnime me kaq shpejtësi”, thotë për Radion Evropa e Lirë ish-drejtori i Policisë së Kosovës, Reshat Maliqi, i cili tani shërben si kryesues i shqyrtimit të përdorimit të forcës dhe të armëve të zjarrit në këtë institucion. Ai sugjeron që trajnimi për policët e rinj të zgjasë së paku gjashtë muaj ose më shumë, në mënyrë që ata të jenë të aftë

## Sa gjenerata policësh dolën këtë vit?

Me kohëzgjatje të reduktuar të trajnimit, këtë vit dolën tri gjenerata policësh: 59, 60 dhe 61. Sipas Policisë së Kosovës, gjenerata e 59 kishte 449 policë dhe u punësua më 22 janar. Gjenerata e 60 kishte 460 policë, që u punësuan më 29 prill, dhe e 61-ta kishte 467 policë, që u punësuan më 21 tetor.

për adresimin e situatave të ndryshme. “Në disa fusha - me aq sa kam njohuri unë - bëhen vetëm dy apo tri orë trajnim për disa pajisje. Me ato orë, ku të shkohet në terren? Ku dhe si të përdoren ato [pajisje]?”, thotë Maliqi.

Sipas tij, ka një numër policësh - kryesisht të rinj - që hasin në vështirësi gjatë zbatimit të ligjit, për shkak të mungesës së njohurive të duhura.

Problemet më të mëdha thotë se lidhen me përdorimin e armëve, pasi koha e trajnimit për to është përgjysmuar - nga tetë orë sa kanë qenë për armë të gjata, janë bërë katër - dhe kjo “është shumë pak”.

“...sepse kemi vetëlëndime të policëve, të anëtarëve të familjes, por edhe të kolegëve, të cilët kanë pësuar për shkak të përdorimit të armëve jo siç duhet”, tregon ish-drejtori i Policisë.

Në Inspektoratin Policor të Kosovës konfirmojnë se, këtë vit, kanë regjistruar katër raste të shkrepeve aksidentale të armëve nga policët, të cilat janë duke u trajtuar në koordinim me Prokurorin e

Shtetit.

Të dhënat që ia siguroi Radios Evropa e Lirë ky Inspektorat, tregojnë se në nëntë muajt e parë të këtij viti, ai ka pranuar dhe ka menaxhuar gjithsej 1.524 ankesa për policët.

Prej tyre, gati 1 000 ankesa janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për Hetime të Brendshme, ndërsa mbi 500 janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve, nën dyshimet për veprimtari penale.

Në përgjigjen e Inspektoratit thuhet se, në krahasim me vitin e kaluar, ka një rritje të lehtë të numrit të ankesave për policë, por nuk specifikohet më shumë.

Në lidhje me shkurtrimin e kohëzgjatjes së trajnimit të policëve të rinj, Inspektorati nuk deshi të përgjigjej, duke e referuar Radion Evropë e Lirë të Policia e Kosovës dhe tek Akademia e Kosovës për Siguri Publike.

Inspektorati tha vetëm se gjatë realizimit të inspektimeve në një numër stacionesh policore, ka hasur në situata ku

përfshirja në kurset e ricertifikimit nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar.

Në këto raste tha se “ka rekomanduar përfshirjen më të madhe të zyrtarëve në kurset e tilla”.

Për këtë temë, Radio Evropa e Lirë kontaktoi edhe Ambasadën amerikane në Prishtinë, pasi SHBA-ja ofron trajnime të ndryshme për policët kosovarë, por ajo nuk u përgjigj.

Eksperti i çështjeve të sigurisë në Kosovë, Nuredin Ibishi, thotë për Radion Evropë e Lirë se ky shkurtrim i kohëzgjatjes së trajnimit të policëve kosovarë nuk mund të justifikohet, pasi rrezikon të ndikojë ndjeshëm në performancën e tyre, kur bëhet fjalë sidomos për përdorimin e armëve të zjarrit. Ai beson se prapa këtij vendimi qëndron nevoja për shtimin e kapaciteteve njerëzore, por thotë se një gjë e tillë është dashur të adresohet më me kujdes.

Mungesa të policëve ose të gradimit të tyre ka pasur edhe më herët, sipas Ibishit, dhe kjo nuk është një problematikë e re. “Është dashur të planifikohet me kohë trendi i pensionimit apo çështja e mungesës së kuadrove. Por, kur bëhen programet e tilla, [Policia] i anashkalon ekspertët e fushës, njohësit e çështjeve të sigurisë dhe [profesionistët] e nivelit akademik”, thotë ai.

Nga Policia e Kosovës bëjnë me dije se dorëheqje në tre

vjetët e fundit kanë dhënë 727 pjesëtarë, por nuk i japin arsyet. Megjithatë, në mesin e tyre janë mbi 500 policë nga radhët e komunitetit serb në veri të Kosovës të cilët kanë dhënë dorëheqje në nëntor të vitit 2022, në kuadër të tërheqjes kolektive të serbëve nga institucionet e Kosovës për shkak të përpjekjeve të Qeverisë së Kosovës për zëvendësimin e targave serbe të makinave.

Autoritetet e Kosovës kanë thënë se kthimi i tyre në radhët e policisë nuk është më i mundur. “Ne i kemi pritur ata zyrtarë rreth 30 ditë për t'i rishikuar potencialisht vendimet e tyre. Kjo nuk ka ndodhur. Ne kemi vazhduar me punën tonë të përditshme. Kemi vazhduar me proceset e

rekrutimit të pjesëtarëve [të rinj] të komunitetit serb”, ka thënë ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, në një intervistë për Radion Evropë e Lirë më 24 shtator.

Pagat e policëve të Kosovës nisnin nga 210 euro në muaj për kadetët policorë dhe arrijnë në mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm.

Mosha e pensionimit të policëve është 65 vjeç.

Një projektrezolutë që përfshinte pensionimin e parakohshëm të tyre - e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës në opozitë në tetor të vitit të kaluar - nuk u çua përpara nga Kuvendi i Kosovës.

Policët e Kosovës nuk kanë as sigurim shëndetësor, as jetësor.


## Sa trajnohen policët në rajon?

Në Shqipëri trajnimi bazë i policëve zgjat gjashtë muaj, po kaq edhe në Serbi.

Në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës trajnimi për gradën “polic” zgjat gjithsej tetë muaj, nga të cilët pesë muaj janë mësim teorik në Akademinë e Policisë së Ministrisë Federale të Arsimit dhe Kulturës dhe tre muaj praktikë në agjencitë policore. Në Republikën Sërpska të Bosnjë-

Hercegovinës kohëzgjatja totale e trajnimit policor dhe formimit profesional është 14 muaj, nga të cilët 36 javë mësimore në Akademinë e Policisë dhe gjashtë muaj në njësitë organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Sërpska.

Në Maqedoninë e Veriut trajnimi për policët e rinj zgjat 12 muaj, ndërsa në Mal të Zi dy vjet.



## Kurti viziton njërën nga depot ku janë vendosur furnizimet e fundit me armatim të ushtrisë

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka vizituar njërën nga depot ku janë vendosur furnizimet e fundit me armatim për Ushtrinë e Kosovës. Lajmin e ka dhënë Kurti në rrjetin social "Facebook" ku, ndër të tjera, ka shkruar se këtë vizitë e bëri bashkë me

komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Kurti tha se ky armatim modern është në kuadër të blerjeve dhe furnizimeve të vazhdueshme që janë duke u bërë për FSK-në. "Së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së

Kosovës, Gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci vizitua njërën nga depot ku janë vendosur furnizimet e fundit me armatim për ushtrinë tonë. Ky armatim modern është në kuadër të blerjeve dhe furnizimeve të vazhdueshme që jemi duke

i bërë për forcën tonë dhe është vetëm një pjesë fare e vogël e sasisë më të madhe të armatimit të këmbësorisë që ndonjëherë kemi marrë", ka shkruar Kurti.

Kryeministri ka thënë se ngritja e kapaciteteve ushtarake ka qenë dhe do të jetë gjithnjë në shërbim të



mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit tonë territorial dhe të ruajtjes së paqes dhe sigurisë.

## Debati Peci - Pacolli, akuza dhe kundërakuza për ofertat politike dhe korruptive

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Përplasjet në rrjetet sociale në mes të aktorëve politikë kohën e fundit janë shpeshtuar. Një përplasje e tillë ka ndodhur ndërmjet ministrit të Bujqësisë, Faton Peci dhe kryetarit të AKR-së, Behgjet Pacolli. Ky i fundit ka reaguar ndaj një deklarate që ministri Peci tha se i kishte ofruar poste në AKR. Kreu i AKR-së, Behgjet Pacolli, në një reagim në "Facebook", ka shkruar se ministri Peci po gënjen. "Kërkoj ndjesë publike që po detyrohem, për herë të fundit të merrem me këtë. Prapë ky Peci në emisionin "Te Fidani" gënjeu! Ndal, more, mos gënje! A është për shkak të urtësisë dhe edukatës sime që nuk ke frikë dhe sulmon mua? Ndal njëherë", ka shkruar Pacolli.

Pacolli tutje ka shtuar se Peci kishte shkruar tek ai para zgjedhjeve të vitit 2014 dhe i kishte kërkuar të jetë pjesë e

listës së AKR-së.

Madje Pacolli shton se Peci atë kohë e kishte fyer LDK-në dhe lidhshpinin e saj.

"Unë nuk mund t'i ofroja një vend në listën e AKR-së. Pas mikpritjes së zakonshme në shtëpinë time, ai është larguar. Peci po gënjen kur pretendon se i kam ofruar të bëhej shef kabinetit të Agim Bahtirit. Agim Bahtiri kishte ekipin e tij, dhe atëherë, Peci ishte i panjohur për ne. Peci po gënjen kur pretendon se i kam ofruar postin e zëvendësministrit të MPJ-së. Si mund t'i ofroj dikujt diçka që ne nuk e posedojmë? Në atë kohë, mandati ynë qeveritar kishte përfunduar; ishim në proces zgjedhor dhe, pa qenë pjesë e qeverisë, nuk kishim asnjë mundësi t'i ofronim një post të tillë", ka shkruar Pacolli.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës tutje ka shtuar se ministri i Bujqësisë po gënjen kur thotë



se dikush në shtëpinë e tij i ka ofruar banesë në Prishtinë dhe 200 000 euro.

"Ai duhet të sjellë fakte për këtë gënjeshtëri, përndryshe do të duhet të përgjigjet para drejtësisë. Një akuzë e tillë është e rëndë dhe e natyrës korruptive. Peci nuk duhet të tentojë të devijojë vëmendjen duke njollosur emrin tim. Ai duhet të përballet me akuzat që po i bën gjithë Kosova ndaj tij", ka shkruar Pacolli.



Ministri Faton Peci një ditë më parë në emisionin "DPT te Fidani" ka thënë se është njëfarë beteje provinciale e një lagueje të Marecit. "Është t'u ndodh njëfarë beteje mes kushërinjve dhe nuk marrë pjesë në beteja të mëhallës", ka deklaruar Peci.

Ai ka treguar edhe arsyen pse kishte shkruar në shtëpinë e Behgjet Pacolli. "Po, kam qenë në shtëpi të Pacolli dhe e kam borxh për t'u treguar qytetarëve

se cila ka qenë biseda brenda. Unë kam qenë më 2009-2013 asamblist i LDK-së në Mitrovicë. Betejat me PDK-në i kam pasur të ashpra për shkak se grupet banditeske nuk kanë lënë pa shkatërruar asgjë në qytet. Këshilltari i tij më ka thirrur se Baci po do me ta qitë një kafe dhe për të falënderuar që i kam ndihmuar Agim Bahtirit. Kur hyra në shtëpi Pacolli ka pas ofertë për mua. Më ka thënë që unë e di që ti je në LDK, por nuk ki të ardhme (aty) dhe në zgjedhjet e ardhshme nuk kandidon. I thashë ku pe di? Më tha unë kam informacione. E dyta ma ka ofruar pozitën e zëvendësministrit të Punëve të Jashtme. Po flasim për nëntorin e vitit 2013. Më ka thënë se duhesh me qenë shef i kabinetit të Agim Bahtirit, me qenë kryetar i AKR-së në Mitrovicë. Prej numrit 5-10 zgjidhe numrin që po do me qenë kandidat për deputet...", tha Peci.

## Konjufca falënderon Gjermaninë për përkrahjen dhënë Kosovës

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa të Parlamentit të Bavarisë, të kryesuar nga Josef Zellmeier. Pasi i falënderoi për vizitën, Konjufca shprehu mirënjohjen për kontributin dhe mbështetjen e Gjermanisë si në të shkuarën ashtu edhe aktualisht.

Ai potencoi se për lidhjen e ngushtë mes dy shteteve tona kontribut të madh ka edhe mërgata e Kosovës që jeton dhe punon në Gjermani, duke



përfshirë edhe rajonin e Bavarisë, e që në këtë mënyrë ata i kanë sjellë edhe më afër vendet tona.

Konjufca foli mbi nevojën që bashkëpunimi i ngushtë mes dy vendeve të thellohet edhe më tutje dhe në të gjitha fushat,

duke përfshirë edhe atë parlamentare.

Ai e njoftoi kryetarin e komisionit Josef Zellmeier me synimet dhe angazhimin e institucioneve të Republikës së Kosovës për sigurinë, shtetin e së drejtës dhe për fuqizimin e mëtejshëm të demokracisë, duke i quajtur këto një parakusht të domosdoshëm të zhvillimit ekonomik.

Po ashtu, ai shtoi se Kuvendi i Kosovës aktualisht është i angazhuar me miratimin e buxhetit për vitin 2025, që prek çdo qytetar dhe që paraqet një vizion për t'ia kthyer atyre në

mënyrën më të mirë të mundshme atë buxhet të grumbulluar prej vetë atyre. Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa të Parlamentit të Bavarisë, Josef Zellmeier, në emër të tij dhe të pjesëmarrësve të tjerë, e falënderoi Konjufcën për pritjen dhe shprehu nevojën e thellimit të raporteve të mira, sidomos në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Bavarisë. Ai shprehu gatishmërinë për angazhim në drejtim të këtij bashkëpunimi dhe nevojën për tejkalimin e sfidave që dalin përpara.

## Fillojnë punimet për transformimin e rrugës "Rexhep Luci"

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Të mërkurën kanë nisur punimet për transformimin e rrugës "Rexhep Luci" në Prishtinë, një projekt që synon ta shndërrojë këtë hapësirë në një zonë më të sigurt, funksionale dhe të gjelbëruar për këmbësorë. Fillimet e punimeve i

përruan kryetari i Prishtinës dhe Drejtori për Investime Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave, Krenar Xhaferi, të cilët theksuan rëndësinë e këtij projekti për qytetarët e kësaj zone. "Ky investim përfshin përdorimin e materialeve prej guri,

shtimin e drunjve dhe krijimin e një mjedisi të integruar që lidhet me pjesën e sipërme të qytetit. Me një dizajn modern dhe ekologjik, rruga 'Rexhep Luci' pritet të bëhet një model i transformimit urban në kryeqytet", ka thënë Rama.

Ndërkaq drejtori për Investime Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave ka treguar për kohëzgjatjen e punimeve. "Punimet pritet të përfundojnë brenda 120 dite. Do të fillojmë me pjesën nëntokësore e më pas rreth shkurtit do të fillojmë me



rregullimin e hapësirës mbi, e cila lidhet deri te Ministria e Kulturës", ka theksuar Xhaferi.

## Kurti dhe ministri Çeku vizituan Rezidencën e ish-presidentit Rugova, ndërhyrjet restauruese drejt përfundimit

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, vizituan Rezidencën e ish-presidentit Ibrahim Rugova, për t'i parë nga afër punimet që po bëhen drejt finalizimit të ndërhyrjeve restauruese. Aty ata u mirëpritën nga familja Rugova, e cila u shprehi mirënjohje për kujdesin institucional dhe

rezultatit e punës së bërë deri më tani. "Rezidenca e presidentit historik Ibrahim Rugova do të vazhdojë të ruajë kujtesën mbi njërën ndër periudhat më të rëndësishme të popullit tonë", u shpreh kryeministri.

Ai falënderoi zonjën Rugova dhe familjen Rugova për bashkëpunimin dhe qëndresën. Kryeministri Kurti tha se: "Jemi të interesuar që të

shkojë gjithmonë mirë dhe të dalë gjithçka sa më bukur, dhe objekti i Rezidencës të jetë sa më reprezentativ për vizitorët të cilët këtu edhe ndihen këndshëm dhe kanë shumëçka të mësojnë".

Restaurimi po udhëhiqet nga ekupe profesionale në respekt të vlerave që ka kjo shtëpi, e cila është pjesë e listës së aseteve të trashëgimisë që mbrohen me ligj.



## Policia e Kosovës dhe UNDP-ja mbajnë trajnime lidhur me kontrollin efikas të armëve të vogla dhe të lehta

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Programin për Siguri (KSSP) të UNDP-së në Kosovë, është e përkushtuar për promovimin e paqes së qëndrueshme përmes gasjeve gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese lidhur me kontrollin efikas të armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe eksplozivëve. Gjatë javëve të fundit janë organizuar me sukses 6 sesione trajnime, secila dyditore, në drejtoritë rajonale të Policisë në Prishtinë, Ferizaj dhe Pejë për 240 zyrtarë të



Policisë në Bashkësi (56 gra dhe 184 burra), anëtarë të Komiteteve Lokale të Sigurisë Publike (KLSP) dhe Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSBB). Këto sesione

trajnuese u fokusuan në rolin e policimit në bashkësi dhe ndërlidhjen me policimin e udhëhequr nga intelijenca në kontrollin e armëve të vogla dhe armëve të lehta (SALW),

kornizën vendore dhe ndërkombëtare që rregullon fushën për kontrollin e AVL-ve, armët e konvertuara, njohjen e pjesëve të armëve, eksplozivëve dhe eksplozivëve artizanale, përfshirë prekursorët e tyre dhe parandalimin e keqpërdorimit të armëve në rastet e dhunës në familje.

Duke bashkuar zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe anëtarët e forumeve të sigurisë në bashkësi, këto sesione trajnime përmirësuan kuptimin e pjesëmarrësve për rreziqet e lidhura me AVL-të, duke nxitur një bashkëpunim më të madh midis anëtarëve të bashkësisë

dhe zyrtarëve të Policisë.

Së bashku po avancojmë ndërgjegjësimin, forcojmë partneritetet dhe po kontribuojmë për një Kosovë më të sigurt për të gjithë. Këto sesione trajnuese janë mundësuar me mbështetjen financiare nga Gjermania, Suedia, Holanda, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Norvegjia përmes fondit të mirëbesimit MPTF dhe mbështetur nga Bashkimi Evropian për zbatimin e udhërrëfyesit rajonal për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Ballkanin Perëndimor.

## Policia konfiskon armatim në veri, dyshon për lidhje me rastin Banjska



Prishtinë, 20 nëntor - Policia e Kosovës ka kryer kontrollin në rrugën "Kralj Petri" në Zvečan dhe aty ka gjetur sasi të konsiderueshme të armatimit. Përmes një komunikate, policia ka thënë se rasti ka të bëjë me një person me interes, që dyshohet se lidhet me rastin Banjska.

Në njoftimin e policisë është thënë se gjatë kontrollit ka gjetur kavanozë prej plastike të groposur në dhe, në të cilët ka pasur uniforma ushtarake, armë AK47, granata dore dhe

fishkë.

Autoritetet e Kosovës kanë ngritur aktakuzë kundër më shumë se 40 personave për sulmin që është kryer në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit të kaluar nga një grup serb.

Si pasojë e sulmit është vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës Afrim Bunjaku.

Në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues serbë.

Përgjegjësinë për sulmin e ka marrë ish-nënkryetari i Listës

Serbe, Millan Radoiqiq, ndaj të cilit është ngritur, po ashtu, aktakuzë. Ai aktualisht besohet se është i lirë në Serbi.

Tre të akuzuar janë të paraburgim në Kosovë, ndërsa pjesa tjetër në arrati.

Autoritetet e Kosovës e fajësojnë shtetin e Serbisë për këtë sulm që e konsiderojnë terrorist, mirëpo Beogradi zyrtar mohon gjithçka.

Faktori ndërkombëtar i ka bërë thirrje disa herë Beogradit t'i mbajë përgjegjës personat e përfshirë në sulmin në Banjskë.

## Policia patrullon me vetura inteligjente në katër komunat veriore

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Policia, në kuadër të aktiviteteve të rregullta në ofrimin e sigurisë në trafik, identifikimin e kundërvajtësve si dhe parandalimin e aksidenteve, ka ndërmarrë veprime policore, ndër të cilat edhe përdorimin e automjeteve inteligjente, të cilat ndihmojnë në identifikimin më të lehtë të kundërvajtësve. Automjetet inteligjente mundësojnë që edhe gjatë patrullimit-lëvizjes, përveç

tejkallimit të shpejtësisë, të identifikojnë edhe kundërvajtje të tjera të ndryshme.

Njësitë policore në katër komunat veriore janë përkujdesur për lirimin e hapësirave publike (rrugë dhe trotuare) nga parkingjet e parregullta, me qëllim mundësimin e lirë dhe të papenguar të automjeteve dhe këmbësorëve.

Gjithashtu, policia është përkujdesur në vazhdimësi

për ofrimin e sigurisë pranë shkollave, me qëllim që nxënës të jenë më të sigurt gjatë shkuarjes dhe kthimit nga shkolla.

Me qëllim parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor, Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri apelon tek të gjithë ngasësit që t'i respektojnë dispozitat ligjore në trafik, ta përshtatin shpejtësinë me kushtet e rrugës dhe t'i respektojnë rregullat në trafik.



## Më pak se 20 për qind e pronave në Kosovë janë të regjistruar në emër të grave

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Më pak se 20 për qind e pronave në Kosovë janë të regjistruara në emër të grave. Nga 625 mijë prona të regjistruara në Kosovë, vetëm 126 mijë janë në emër të grave. Gjendja aktuale e të drejtave pronësore të grave, sipas Avokatit të Popullit, Naim Qelaj, nuk është e mirë. "Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze është të shohim se sa po gjen zbatim ligji

dhe se po arrijnë gratë t'i gëzojnë të drejtat në pronë. Gjendja aktuale sipas statistikave nuk është e mirë. Më pak se 20 për qind të grave kanë të regjistruar pronat në emër të tyre", tha Qelaj. Ai shtoi se problematike është edhe ndarja e pasurisë bazuar në vlerësimin e kontributeve. Në tryezën e diskutimit me temën "Të drejtat pronësore të grave: Korniza ligjore, teoria dhe praktika", Xhevat

Azemi, ekspert ligjor, foli për numrin e grave që kanë pronat në emër të tyre. "Gjendja nuk është shumë e favorshme. Nga të dhënat e Agjencisë Kadastrale të Kosovës në Kosovë janë të regjistruar 625 mijë pronarë të regjistruar, prej tyre 126 mijë janë femra", tha ai. Profesori në Universitetin e Prishtinës, Abdulla Aliu, tha se është detyrë e shtetit që gruaja të gëzojë pronën e saj./kp/



## Guvernatori Ismaili takon drejtues të lartë të FMN-së, BB-së dhe guvernatorë të bankave qendrore evropiane

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka zhvilluar takime të ndara me drejtues të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankës Botërore (BB) dhe guvernatorë të bankave qendrore të vendeve evropiane. Këto takime guvernatori Ismaili i ka bërë në kuadër të mikpritjes së tij për 25-vjetorin e themelimit të BQK-së, me të cilën ka zhvilluar punimet Konferenca Ndërkombëtare "Ndërtimi i urave përtej kufijve, ndërtimi i ardhmërive: Integrimi në SEPA për gjithpërfshirje financiare - fuqizimi i rritjes dhe reziliencës".

Gjatë tri ditëve të organizimit për nder të 25-vjetorit, guvernatori Ismaili në ambientet e BQK-së ka takuar Alfred Kammer, drejtor i

Departamentit Evropian në FMN, Asad Alam, drejtorin Rajonal për Evropën dhe Azinë Qendrore, Rritje të Drejtë, Financa dhe Institucione nga Grupi i Bankës Botërore, pasuar nga guvernatori i Bankës Kombëtare të Austrisë, Robert Holzmann, guvernatori i Bankës Qendrore të Islandës, Asgeir Jonsson, guvernatori i Bankës Qendrore të Estonisë, Madis Müller dhe Gediminas Simkus, guvernator dhe kryesues i Bordit të Bankës së Lituaniës.

Gjatë këtyre takimeve, krahas falënderimeve për mbështetjen dhe pjesëmarrjen në organizimin e BQK-së, guvernatori i BQK-së i ka informuar të pranishmit mbi zhvillimet aktuale në sektorin financiar, duke nënvizuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar, duke vënë në pah performancën e qëndrueshme



të sektorit, përfshirë normën e ulët të kredive joperformuese dhe nivelin e lartë të kapitalizimit.

Po ashtu, i pari i BQK-së shprehu mirënjohjen e thellë ndaj partnerëve dhe institucioneve ndërkombëtare për avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, qeverisjen korporative dhe infrastrukturën tjetër financiare. Ai, gjithashtu, vlerësoi

bashkëpunimin me bankat qendrore partnere, duke falënderuar shtetet dhe popullin e tyre për mbështetjen e dhënë nga institucionet e tyre, me të cilën BQK-ja ka bashkëpunim të shkëlqyer në aspekt të asistencës teknike dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale. Më tutje, në takim u theksua rëndësia e këtyre partneriteteve për ruajtjen e stabilitetit

ekonomik dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit financiar të vendit tonë për të mirën e të gjithë qytetarëve. Prandaj, edhe konferenca e organizuar kishte tematika të tilla aktuale dhe relevante. U diskutua për vizionin strategjik, planin pesëvjeçar, iniciativat që kanë për synim përmirësimin e qëndrueshmërisë së sektorit financiar, avancimin e rregulloreve dhe promovimin e gjithëpërfshirjes financiare si dhe sfidat.

Në takim u rikonfirmua përkushtimi i palëve për ta forcuar bashkëpunimin, ndërtuar komunikim efektiv për t'i ndarë përvojat, për ta promovuar rritjen e qëndrueshme financiare, duke siguruar që sektori financiar të vazhdojë të zhvillohet në përputhje me standardet ndërkombëtare në funksion të ekonomisë dhe vendit.

## Oda Amerikane mirëpret kthimin për rishqyrtim të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka mirëpritur vendimin e presidentes së Kosovës për kthimin për rishqyrtim të Ligjit nr. 08/L-288 për Mbrojtjen e Konsumatorit, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 31 tetor 2024, si përgjigje ndaj komenteve të Odës Amerikane dhe organizatave të tjera të sektorit

privat.

Oda Amerikane mbështet vlerësimet e presidentes se dispozita kyçe të ligjit në fjalë janë në kundërshtim me dispozita të aktit më të lartë juridik të vendit, Kushtetutës si dhe të ligjeve të tjera.

Oda Amerikane beson fuqishëm se vendimi i presidentes Osmani ka për synim shmangien e



konflikteve ligjore dhe respektimin e autoritetit, përgjegjësisë dhe funksionimit ligjor të

institucioneve të ndryshme të Republikës së Kosovës. "Është imperativ që dispozitat që rregullojnë mbrojtjen e konsumatorit të mos ndërlihen me aspekte të tjera rregullative të cilat nuk rregullojnë në mënyrë primare ose specifike fushën e të drejtave të konsumatorëve dhe mbrojtjen e tyre, siç janë çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin".

Oda Ekonomike Amerikane beson se kthimi për rishqyrtim i këtij Ligji do të mundësojë marrjen në konsideratë të shqetësimeve dhe rekomandimeve të përfaqësuesve të sektorit privat dhe organizatave që avokojnë për të drejtat e konsumatorëve, si demonstrim i përkushtimit për përpjekje gjithëpërfshirëse ndërmjet të gjitha palëve të interesit.

## Kryetari i Gjilanit thotë se ka rritur buxhetin për bujqësi në 1.5 milion euro

GJILAN, 20 NËNTOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin për Bujqësi, Bajram Isufi, kanë vizituar fermerin Lulëzim Shala në fshatin Ponesh, përfitues i subvencioneve nga komuna. "Këtë javë do të ndajmë me qytetarët disa të arritura të jashtëzakonshme në fushën e bujqësisë. Për vitin 2023 kemi ndarë një buxhet të përgjithshëm prej

1.5 milion eurosh për këtë sektor", tha Hyseni.

I pari i komunës shtoi se prej këtij buxheti 800 mijë euro vijnë nga buxheti komunal, ndërsa 700 mijë euro janë siguruar përmes marrëveshjeve të bashkëfinancimit. "Kjo përbën një rritje të jashtëzakonshme krahasuar me vitin 2022, kur gjetëm një buxhet të miratuar nga

qeverisja e kaluar në vlerë prej 390 mijë eurosh", theksoi Alban Hyseni.

Kryetari i Gjilanit shton se, përveç rritjes së buxhetit, një tjetër arritje e madhe është rritja e transparencës për ndarjen e subvencioneve. Sipas tij, sot fermerët dhe bujqit kanë mundësinë të përfaqësohen drejtpërdrejt në Kuvendin Komunal gjatë procesit të ndarjes së

subvencioneve.

Më tej i pari i Gjilanit tregoi se një tjetër hap i rëndësishëm ka qenë edhe krijimi i një zyre të veçantë për bujqit dhe fermerët brenda komunës. Kjo zyrë ka lehtësuar dhe përsheptuar marrjen e shërbimeve dhe është gjithmonë në dispozicion për t'u ndihmuar qytetarëve me çdo pyetje apo nevojë që kanë.





# Roli i Ismail Qemalit në pavarësimin e Shqipërisë

Nga: Evarist BEQIRI

Shumë është folur dhe shumë është shkruar lidhur me rolin e Austro-Hungarisë në realizimin e Pavarësisë së Shqipërisë. Vlen të theksojmë që në fillim se mbështetja politike austro-hungareze dhe italiane ishte tepër e rëndësishme në themelimin e shtetit modern shqiptar. Megjithatë, përtej mitizimeve dhe komplekseve ndaj të huajve, të cilat fshehin në rastin më të mirë injorancën dhe në më të keqin dashaligësinë, vlen që të analizojmë me objektivitet ngjarjet dhe faktet historike. Sepse, sa më të qartë që të shikojmë të shkuarën tonë, aq më të kthjellët mund të dallojmë në mugëtirë të ardhmen tonë ... Përtej servilizmit klishe, duhet theksuar qysh në krye të herës, se Austro-Hungaria dhe Fuqitë e tjera, të gjendura përballë presionit të pansllavizmit në rritje, ishin për ruajtjen e status kuosë në Ballkan. Ato ishin kundër shkëputjes së popujve të tjerë joturq nga perandoria. Prandaj, patriotët shqiptarë kërkonin fillimisht autonominë nga Perandoria Osmane. Shkëputja e shqiptarëve nga shteti osman, qoftë edhe me rrugë revolucionare, do të ligjëronte ndërhyrjen e shteteve fqinje që në fakt e prisnin këtë moment, siç edhe ndodhi.

Në këto kushte patriotët shqiptarë po punonin për ngritjen e shkallës së ndërgjegjes kombëtare duke intensifikuar punën për lëvizimin e gjuhës shqipe dhe hapjen e sa më shumë shkollave në gjuhën amtare. Ismail Qemali, në periudhën që jetoi në Bruksel dhe po punonte për çështjen shqiptare, zhvilloi takime me diplomatët të ndryshëm. I tillë ishte edhe ai me kontin Metsch Khevenhüller, ambasadori austro-hungarez në Bruksel, i cili u përcoll në një raport të dërguar ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, kontit Agenor Maria Goluchowski, nga Brukseli, më 6 qershor 1901. Në raport ai pasqyrore bisedën diplomatike të zhvilluar midis tij dhe Ismail Qemalit.


Në këtë takim Ismail Qemali, i kërkonte drejtpërdrejt konsullit austro-hungarez mbështetjen e Austro-Hungarisë, në çuarjen përpara të çështjes shqiptare, duke zgjuar vetëdijen kombëtare shqiptare me anë të lëvizimit të gjuhës shqipe në shkolla. Njëkohësisht, ai kërkonte mbështetjen për të forcur idenë e autonomisë dhe gradualisht Shqipëria të përgatitet që të qëndrojë vetë në këmbë si shtet i pavarur, në rastin e shkatërrimit eventual të Perandorisë Osmane. Në raportet diplomatike të kësaj periudhe pasqyrohet edhe shtimi i kontrolleve ndaj përdorimit të librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Kjo shfaqje e nervozitetit të autoriteteve osmane dhe shqetësimi i madh i tyre vihet re

menjëherë pas arratisjes së Ismail Qemalit nga Stambolli. Autoritetet turke e kishin rritur vigjilencën në Shqipëri, pasi Ismail Qemali bënte pjesë të shqiptarët më të shquar që shërbenin në shtetin osman. Gjithashtu, Ismail Qemali kishte shumë pasues në Shqipërinë e Jugut, të cilët e vlerësonin atë si një burrë shteti me kulturë të madhe. Këto fakte i shqetësonin autoritetet osmane. Por, ata me reagimin e tyre agresiv ndaj arratisjes së Ismail Qemalit, i veshën atij një aureolë më të shndritshme. Në vazhdim e këtyre veprimeve, pallati ngarkoi Esad pashë Toptanin për të mbledhur nënshkrime në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Veriut, për një deklaratë kundër Ismail Qemalit. Patriotët shqiptarë dhe e gjithë popullata që ishte e pakënaqur me gjendjen, filluan të ushqenin shpresa dhe ideale të mëdha te figura e Ismail Qemalit. Këto zhvillime e shndërruan atë në personalitetin më të rëndësishëm shqiptar. Për pasojë, autoritetet osmane u frikësuan dhe u bënë edhe më tepër nervoze. Ata filluan të kryenin kontrolle të shumta në shtëpitë e patriotëve shqiptarë. Ata kryen edhe arrestime të patriotëve shqiptarë në Shqipëri dhe Turqi.

Qysh në dhjetëvjeçarën e parë të shekullit XX, Ismail Qemali pranohej gjithësisht si udhëheqësi i shqiptarëve. Në të njëjtën kohë, edhe pas fitores së Revolucionit Xhonturk (1908), ai shikohej si një prej figurave kryesore otomane.

Dy ngjarje të rëndësishme për fatin e Ballkanit do të zhvilloheshin në vitin 1908: aneksimi i plotë i Bosnjë-Hercegovinës nga Austro-Hungaria dhe deklarimi i pavarësisë së Bullgarisë. Xhonturqit e kuptuan se, nëse do të ecej në këtë linjë, fundi i sundimit osman do të ishte i shpejtë, ndaj menjëherë ua filluan politikave centralizuese. Në këto momente ekzistonin dy rryma patriotike shqiptare: 1) Krahu kombëtarist i kryesuar nga Ismail Qemali ishte që ky moment të shfrytëzohej dhe shteti osman të njihet zyrtarisht ekzistencën e kombit shqiptar dhe njëkohësisht Shqipëria të vetëqeverisej si një entitet politik i mirëpërcaktuar; 2) Krahu i moderuar, i kryesuar nga Mid'hat Frashëri ishte për avancimin e kërkesave kulturore dhe për arsim në gjuhën shqipe, ndërkohë që ata nuk ishin për kërkesa politike.

Kryengritja e vitit 1910, në Kosovë, u mbështet fuqishëm nga deputetët shqiptarë në Parlamentin Osman, ku spikatën Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga dhe Myfit Libohova. Ismail Qemal Vlora, gjatë aktivitetit në Parlamentin turk, mbrojti me kurajë luftën e shqiptarëve të Kosovës në kryengritjen e vitit 1910 kundër



qeverisë xhonturke, e cila po dhunonte të drejtat dhe liritë e tyre. Në fjalimin e tij, ai u kërkonte xhonturqve që të mbanin fjalën e paraardhësve të tyre e të respektonin traditën shekullore në marrëdhëniet shqiptaro-turke, duke mos u përzier në punët e brendshme të Shqipërisë. Në përshkrimet e politikanëve dhe diplomatëve austriakë, kryengritja në Shqipërinë e Veriut shikohej si veprë personale e Ismail Qemalit. Sipas tyre, ai ishte i bindur se herët a vonë Austro-Hungaria do të detyrohet t'i ndihmojë shqiptarët në luftën e tyre për liri. Por, deri në vitet 1910-1911, qëndrimi dhe politika zyrtare e Austro-Hungarisë ndaj popullit shqiptar nuk shkonte përtej simpatisë dhe interesit që ai të zhvillohej në kuadër të Perandorisë Osmane dhe në pajtim me interesat shtetërorë turq. Austro-Hungaria i shikonte shqiptarët si një element shumë të rëndësishëm i Perandorisë Osmane. Austro-hungarezët ishin si me shqiptarët ashtu edhe me turqit dhe nuk dëshironin të ndërhynin në punët e brendshme të Perandorisë Osmane.

Ndërkohë, Ismail Qemali, me vizionin e tij largpamës, vazhdonte të kërkonte me ngulm mbështetjen e Austro-Hungarisë ndaj çështjes shqiptare, duke parë në horizont shkatërrimin e afërt të Perandorisë Osmane. Aftësitë politike dhe diplomatike të tij do të dilnin përsëri në pah, në formulimin e Memorandumit të Greçës, në qershor 1911. Ky dokument ishte mishërim i kërkesave shqiptare për një autonomi të plotë. Ai ruante frymën e dokumenteve themelore politike të gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Gjithsesi, ky zhvillim politik në tokat shqiptare i dëshmoi opinionit të gjerë ndërkombëtar se në Ballkan kishte ende një problem të pazgjidhur. Ky memorandum u bë dokumenti politik bazë për çfarëdo lloji hapi politik që do të hidhej më pas. Më në fund, në prag të rënies së Perandorisë Osmane, Austro-

Hungaria e pa Shqipërinë e pavarur si aleatën e vetme në Ballkan në përpjekjen e saj për t'i vendosur një barrierë pansllavizmit dhe ekspansionit italian. Por, me gjithë rolin e rëndësishëm të Austro-Hungarisë, pavarësia e Shqipërisë nuk u dhurua. Sepse, askush nuk fal asgjë në arenën e politikës ndërkombëtare. Përveç mbështetjes politike, nga pikëpamja logjistike kërkesa që austro-hungarezët i plotësuan Ismail Qemalit ishte minimaliste, por e rëndësishme. Ata i vendosën në dispozicion një mjet lundrimi për të mbërritur në brigjet shqiptare.

Sagës për pavarësinë shqiptare po i vinte fundi. Ismail Qemali dhe delegatët u nisën nga Trieste drejt brigjeve shqiptare, më 19 nëntor me anijen austriake "Brünn". Në mbrëmjen e 20 nëntorit 1912, nën dritën e hënës vezulluese që po shkëlqente në brigjet shqiptare, pranë Kepit të Rodonit ose Kepit të Skënderbeut, ata zbritën tek anija tjetër austriake "Wurmbrand", ku kaluan natën para zbritjes në Durrës. Nën yjet e netëve magjike të vjeshtës shqiptare, Providenca hyjnore kishte parashikuar që ata para se të kurorëzonin misionin e tyre të shenjtë në Vlorë, duhet që të bënin një ndalesë të fundit, pikërisht para Kështjellës dhe Kishës së Heroit tonë Kombëtar, në Rodon. Duket se heroi ynë kombëtar dëshironte që t'i jepte mbrojtjen dhe bekimin e tij Ismail Qemalit, në këtë vjeshtë të artë të shqiptarisë. Ja si e kujton këtë çast një pjesëmarrës në këtë ngjarje, Dhimitër Zografi: "Në të njëjtën ditë me delegatët e Bukureshtit mbërritën në Trieste edhe Ismail Qemali me Luigj Gurakuqin (që ktheheshin nga vizita në Austro-Hungari - shënim i E.B.). Ata sollën lajmin se Vlora ishte bllokuar nga grekët, ndaj duhej të niseshin menjëherë drejt Durrësit pa u mbyllur ende kjo rrugë. Në dispozicion të delegatëve shqiptarë, Austria kishte vënë vaporin special 'Graf Wurmbrand'. Misioni i tyre do të kishte mbrojtjen e Austrisë dhe Italisë. Në Trieste blenë armë dhe

municione dhe u nisën drejt Shqipërisë. Një vapor tjetër i Austrisë ndiqte gjithçka që ishte duke ndodhur në Shqipëri" Në Durrës, Ismail Qemali nuk dëshironte të vonohej aspak. Ai shpjegoi gjendjen aktuale të Shqipërisë. "Turqia i lau duart nga Ballkani", tha ai, "por, që Shqipëria të mos bjerë në një robëri tjetër duhet të ngremë flamurin dykrenor kuq e zi, dhe të shpallim vetëqeverimin e Shqipërisë të mirëpëritur edhe nga Fuqitë e Mëdha". Një çast gjithë mbledhja mbeti e hutuar, ajo që dëgjuan nga goja e Ismail Qemalit ishte mes së besueshmes dhe të pabesueshmes.

Faktikisht, asnjëra nga Fuqitë e Mëdha nuk kishte ndërmend që të na falte pavarësinë. Nëse ajo nuk do të bëhej në atë moment të fundit, nuk do të mund të realizohej më kurrë. Nëse Ismail Qemal Vlora nuk do të kishte mbledhur patriotët nga mbarë trojet shqiptare atë fund nëntori në Vlorë, me siguri që Shqipëria do të copëtohej njëherë e mirë midis fqinjëve grabitqar. Prandaj, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë duhej të bëhej me çdo kusht, gjallë e vdekur. Vetëm në këtë mënyrë Fuqitë e Mëdha do t'i njihnin të drejtat legjitime të shqiptarëve. Sepse, nëse ka diçka që historia e njerëzimit na mëson, është fakti që çdo betejë për lirinë njerëzore është fituar me anë të forcës. Pavarësia e Shqipërisë i ka themelet te lufta shekullore për liri, te sakrificat dhe gjaku i derdhur ndër shekuj nga shqiptarët. Austro-hungarezët e mbështetën Ismail Qemalin, sepse ishin të vetëdijshëm që ai ishte i vetmi lider që mund t'i bashkonte shqiptarët në këtë moment historik. Ata u pajtuan me krijimin e Shqipërisë së pavarur, pavarësisht përmasave të saj. Fuqia e Perandorisë Austro-Hungareze ndikoi që çështja shqiptare të gjente një zgjidhje, qoftë kjo edhe e pjesshme. Megjithatë, trojet shqiptare u copëtuan brutalisht, duke lenë jashtë kufirit thuajse gjysmën e popullsisë etnike shqiptare.

Ismail Qemali, jo pa trishtim, do të shprehej: “Në qoftë se shqiptarëve nuk do t’u mjaftojnë forcat për të zbrapsur sulmin e padrejtë [të fqinjëve], atëherë ata nuk do ta humbin shpresën se kombet e qytetëruara të Evropës dhe sidomos Fuqitë e Mëdha, të cilat ... do ta njohin drejtësinë e synimeve tona. ... Edhe nëse diplomacia nuk do t’i njohë menjëherë të drejtat e shqiptarëve, koha do t’i njohë ato paqetë më vonë”.

Në intervistën e dhënë për gazetën më të madhe austriake të kohës, “Neue Freie Presse”, në Vjenë më 8 nëntor 1912, Ismail Qemali shpalosi idetë e tij për politikën që do të ndiqte shteti shqiptar në raport me fqinjët ballkanikë. Ai e krahason pretendimin e Serbisë për të pasur një port në Adriatik, njësoj sikur Zvicra e rrethuar me male të thoshte, meqë nuk ka dalje në det, nuk mund të ekzistojë dot në qoftë se nuk i jepet porti i Gjenovës. Ismail Qemali deklaroi më tej se Shqipëria e pavarur do të jetë një shtet me rreth dy milionë e gjysmë banorë. Ky shtet duhet të përfshijë të tërë Vilajetin e Shkodrës, pjesën shqiptare të vilajetit të Janinës, pjesën shqiptare të Manastirit, pjesën perëndimore të Manastirit përreth Ohrit, Dibërën, Elbasanin, Korçën, sanxhakun e Pejës me Gjakovën, sanxhakun e Prizrenit, një pjesë të Sanxhakut të Shkupit dhe një pjesë të sanxhakut të Prishtinës. Duke marrë si model “fanarin e lirisë” në botë, ShBA-në, Ismail Qemali tha: “Kryeqyteti i Shqipërisë mund të ishte Elbasani, për arsye të pozitës së tij qendrore, por rol të madh mund të luante edhe Vlorë ku mund të shkente hekurudha. Elbasani mund të ishte Uashingtoni, ndërsa Vlorë të ishte Nju-Jorku ynë”. Për marrëdhëniet me dy fuqitë të cilat përkrahnin idenë e shtetit të pavarur shqiptar, ai shprehej se dëshironte të kishte marrëdhënie të mira me Austro-Hungarinë dhe me Italinë, në mënyrë që këto dy shtete të mbështesin nevojat tona kulturore dhe ekonomike. “Një vendi të vogël i nevojitet përkrahja e shteteve të mëdha dhe është e qartë se kjo mbështetje te dy vendet aleate të Adriatikut, Austro-Hungaria dhe Italia, do të vijë vetvetiu. Kështu, monarkia e madhe fqinje, mysafir i së cilës jam tani, mund të ketë vetëm përfitime nga një Shqipëri e pavarur”, përfundon Ismail Qemali.

Patrioti i shquar gjirokastrit, Thoma Papapano, na sjell një dëshmi autentike kur përshkruan në kujtimet e tij një vizitë që zhvilloi një delegacion qeveritar shqiptar në Evropë në vitin 1913, për të mbrojtur trojet shqiptare nga copëtimi. Në përbërje të delegacionit ishin disa personalitete shqiptare, si Myfid Libohova, Petro Poga, Rauf Fico, Thoma Papapano, Eqrem Vlora, Lame Petri dhe Ajet Libohova. Interesant është përshkrimi që ai i bën takimit të zhvilluar në Vjenë, më datë 21 gusht 1913, me ministrin e Jashtëm austro-hungarez, kontin Leopold Berchtold: “E, kur ishim duke dal nga zyra e tij duke e përshëndetur e duke e falënderuar, na ndali e na tha:

‘Është folur e flitet se kemi qenë ne që e shtytëm Ismail Qemal beun të vente në Shqipëri dhe të shpallte pavarësinë e atdheut tuaj, po kjo nuk është e vërtetë. Ju e dini që Ismail Qemali shkoi nga Stambolli në Bukuresht, mbledhi atje shqiptarët e Kolonisë shqiptare të Rumanisë dhe me ta vendosi të shpallet Pavarësia e Shqipërisë. Pra, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë ka qenë iniciativa e vetë Ismail Qemalit. Kjo duhet të dihet’ (AQSH. F. 441, D, 846. Kujtime të Thoma Papapanos, f. 103-111). Ky rrëfim përputhet edhe me një tjetër dëshmi autentike, të shkruar te gazeta “Bashkimi i Kombit”, më 11 gusht 1944: “Myfit Libohova mbi disa ngjarje”, shkruan Ali Asllani, “ish larguar i zemëruar nga Plaku, nuk vinte të merrte pjesë në mbledhje të Këshillit Ministror, por kur u kthye nga Vjena dhe nga Roma që kish vajtur, ndryshoi sjelljet e tija dhe në mbledhjen e parë të Këshillit erdhi. Atë ditë, para se të fillonin bisedimet, duke iu drejtuar Ismail Qemalit tha: ‘Bej Efendi, të më falni, unë kam pandehur se zotrote erdhe në Shqipëri i shtytur dhe i këshilluar nga dy mbretëritë mbrojtëse, kurse nashti që isha në Vjenë dhe në Romë nga goja kompetente dëgjova dhe mora vesh të vërtetën; pra më epni leje të ju puth dorën’”.

Ministri austro-hungarez i Punëve të Jashtme, konti Berchtold, më 17 nëntor 1912 kërkoi bashkëpunimin e Italisë lidhur me rregullimin e problemit shqiptar. Në telegramin drejtuar homologut të tij italian, ai bënte me dije interesin e përbashkët që palët kishin në krijimin e një Shqipërie autonome, që duhej të përfshinte në kufijtë e saj të gjitha territoret që banohen ekskluzivisht prej shqiptarëve, ose të paktën, krahina të banuara në shumicë prej tyre. Austro-Hungaria nuk e mbështeste daljen e Serbisë në Adriatik, ndërsa në lidhje me kufijtë e Jugut, pranonte t’i jepte Greqisë territorin në jug të lumit Kalamas. Rivaliteti midis Austro-Hungarisë dhe Italisë në çështjen shqiptare ndikoi në arritjen e një marrëveshje midis tyre që në vitin 1907. Sipas marrëveshjes të arritur nga ministri i Jashtëm, Erental dhe Titoni, formimi i shtetit shqiptar ishte e vetmja zgjidhje që ju përgjigjej interesave të tyre reciproke, në rast pamundësie të ruajtjes së sundimit osman në këtë rajon. Qëndrimi i tyre për ruajtjen e status kuosë mbeti i pandryshuar edhe pas fillimit të luftërave ballkanike. Dhe, në fund, Fuqitë e Mëdha do të pajtoheshin me krijimin e një Shqipërie të pavarur, paçka se cilat territore do të përfshiheshin në shtetin e ri.

Diplomati austriak, Alfred Rappaport, i cili ishte njohësi më i mirë i Ballkanit dhe Shqipërisë në ministrinë e Jashtëm austro-hungareze, ka shkruar se shpallja e pavarësisë nga Ismail Qemali “ka qenë një kusht kryesor për ndryshimin e planeve rrënuese kundrejt Shqipërisë. Ismail Qemali diti të zgjedhë në mënyrë gjeniale vendin dhe kohën për veprën e madhe diplomatike”. “E vetmja punë e mirë gjatë këtyre



dy muajve (d.m.th prej shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike deri në hapjen e Konferencës së Londrës)”, ka thënë thotë Alfred Rappaport, “qe ajo e Ismail Qemalit, d.m.th, shpallja e vetëqeverimit të Atdheut të tij në Vlorë më 28 nëntor. Kryetari i Qeverisë së Përkohshme kishte një kuptim të thellë diplomatik, sepse diti të zgjidhte kohën më të volitshme për hapin që bëri; kështu që, me shfaqjen e vullnetit të popullit shqiptar u dha në dorë atyre që përpiqeshin për vetëqeverimin e Shqipërisë një argument që shëndoshë për konferencën që do të hapej. Përveç kësaj, ishte një punë me të vërtetë shumë e urtë shpallja e Pavarësisë në një vend të cilin aleatët ballkanikë nuk e kishin pushtuar akoma; sepse, për këta nuk ishte gjë e lehtë t’ia mbyllnin gojën Qeverisë së Përkohshme”.

Në prag të përvjetorit të parë të pavarësisë në tetor 1913, Ismail Qemali, në fjalimin para popullit në Vlorë, ndër të tjera thotë: “Mundet se q’atëhere e gjer më sot qeveria nuk i bëri disa gjera që duheshin bërë, apo bëri ligisht disa të tjera; po të jeni të siguarur se punoi ashtu duke mos mundur të sillej ndryshe. Një punë me vlefë të madhe s’munt t’i mohohet qeverisë sonë, të mbajturit lart e flamurit të lirisë. Asht kjo një punë me rëndësi? Po s’ka dyshim! Veç kësaj duhet të vini re përpjekjet që bani qeveria për të mos lanë të vobektin të vuajë. Kur Europa ish duke vendosur fatin t’ënë, na rronim në këtë qytet të mbyllur, pa pasur asnjë marrëdhanije me botën e jashtëm dhe pa ditur se qysh do t’i vente filli çështjes sonë. Kuptohet lehtas, pra, se interesi i math që për ne që të

dilnim përjashta e të përpiqeshim për të drejtat t’ona që ishin në rrezik. Gjetëm mënyrën për të dalur, dualëm dhe pikë së pari u përpoqëm për hapjen e bllokut, që qarkonte Vlonën e që aq shtërngime i kishte sjellur njerzisë së këtyre viseve, sa që me gjith masat e qeverisë, njerëzia druante fort ditën e nesërme. Përjashta e kuptuam qysh edhe kush ishte përpjekur për të mirën e këtij vendi. Mbasi ishte vendosur që të bahej një Shqipërie, gjendej ahëre nën bisedim çashtja e kufijve të jugës sepse nga ana e veriut dhe verilindjes konferenca ua kishte dhanë dënimin e vdekjes së Kosovës edhe Dibërës. S’ka dyshim, ish detyrë e qeverris, të përpiqej që të mos jes asnjë Shqiptar jashtë Shqipërisë. Por, fatkeqësisht, nuk ishim mjaft të përgatitur dhe me gjithë që Austria i mbajti 1 milion ushtarë në këmbë, dhe Italia u përpoq me gjithë mënyrat dhe Anglia desh të na mbrojtë por, që të mos kërcasë një luftë europiane, u shtërngua të na bëjë theror”. Në mbyllje Ismail Qemali Vlora e parashikoi se, do të vij dita kur do të ketë drejtësi për çështjen shqiptare dhe deklaroi: “Ne kemi besim të patundëm te drejtësia e atyne q’e kanë në dorë fatin e kombit t’onë. Ata do të dinë t’i peshojnë arësytet q’e shtyjnë Malësorin t’onë të rëmbejë pushkën e t’a fitojë me ndihmën e ‘saj atë të drejtë të cilën s’mundi t’a fitojë me urtësi pasi u përpoq dhe e cila duheshë fituar me doemos. Na presim të shohim Europën duke vënë në peshën e ‘saj, drejtësiën, durimin, urtësiën dhe gjakun t’onë të derdhëm bujarisht me n’anë; dhe m’anën tjetër padrejtësiën, poshtësiën,

dhe gjakun e Serbëve të derdhun cubërisht”.

Mit’hat Frashëri, i cili shërbeu në Qeverinë e Vlorës, do të shprehej: “Pa dashur të bënj apologjinë e Ismail Qemal beut, i cili në të tjerë pika mund të ketë do të meta, padyshim që ai pati meritën e iniciativës dhe te talentit diplomatik, dhe këto cilësi do t’i sigurojnë për kurdoherë një vënt në kujtimet mirënjohëse të kompatriotëve të tij dhe të albanofilëve”.

Ismail Qemali Vlora hodhi themelet e ndërtimit të shtetit modern shqiptarë. Ai konceptoi vijën politike mbi të cilën do të ecte ky shtet. Mbi trashëgiminë e tij u ngritën themelet e institucioneve shtetërore shqiptare. Vizioni i Ismail Qemalit vijon që t’a udhëheqë diplomacinë shqiptare. Doktrina politike e Ismail Qemalit e konceptoi Shqipërinë si një faktor ekuilibri, stabiliteti dhe paqeje në Gadishullin e Ballkanit; një rol të tillë Shqipëria e ka luajtur dhe vijon të luajë me sukses edhe sot e gjithë ditën në Gadishullin Ilirik.

Ismail Qemali theksoi rëndësinë e faktit që për ta realizuar përfundimisht këtë synim, duhet që të respektohen të drejtat kombëtare, pavarësia dhe tërësia territoriale e shtetit të ri shqiptar: “Jemi të bindur se qëndrimi me drejtësi ndaj nesh do të jetë jo vetëm në të mirën tonë, por edhe të atyre që synojnë të përfitojnë në kurrizin tonë. Rindërtimi i bllokut ballkanik dhe garantimi i tij do të jetë një nga faktorët më të frytshëm për paqen në Lindje dhe në botë. Ngrehina e Ballkanit mund të jetë e qëndrueshme vetëm po të forcohet Shqipëria, që përbën shtyllën e katërt mbajtëse të saj”.



## Drita mposht Suharekën dhe merr primatin në Superligë

**GJILAN, 20 NËNTOR** - Drita e ka fituar ndeshjen e mbetur të xhiros së tretë të Superligës së futbollit ndaj Suharekës. Gjilanasit kanë fituar me rezultat 4:2 për ta marrë të

vetëm primatin në ligën elitare. Golat për vendësit i kanë shënuar Arb Manaj (35'), Blerim Krasniqi (49' e 63') dhe Albert Dabiqaj (57').

Për Suharekën kanë shënuar Liridon Fetahaj (54') dhe Alden Skrelji (87'). Falë kësaj fitoreje, Drita ka shkuar në kuotën e 28 pikëve pas 13 ndeshjeve të zhvilluara,

duke u shkëputur kështu në tri pikë ndaj rivalit për titull, Ballkanit. Kjo ndeshje ishte shtyrë shkaku i angazhimeve të gjilanasve në garat evropiane.



# Vendos UEFA, Kosova e humb ndeshjen me Rumaninë me rezultat zyrtar 3:0

**NYON, 20 NËNTOR** - UEFA e ka marrë të mërkurën vendimin për ndeshjen e ndërprerë në mes të Rumanisë dhe Kosovës. Shtëpia e futbollit evropian ka vendosur që këtë ndeshje ta regjistrojë me rezultat zyrtar 3:0 për rumunët pas mbledhjes së Komisionit Disiplinor të saj.

UEFA e pa fajtoje Kosovën për tërheqjen nga loja në minutat shtesë dhe për mosbindje të urdhrat të referit për t'u rikthyer në fushën e blertë.

Gjithashtu, dy kombëtares janë gjobitur për ato që kanë ndodhur të premtën e javës së kaluar në stadiumin "National Arena" në Bukuresht.

Federata Rumune e Futbollit ka marrë gjoba të shumta që kapin vlerën e 128 mijë eurove dhe me një ndeshje pa praninë e shikuesve si vendëse për shkak të thirrjeve raciste apo diskriminuese të tifozëve të saj.

UEFA ka vendosur ta gjobisë Federatën e Futbollit të Kosovës me 6 000 euro për sjellje të pahijshme të ekipit kombëtar. FFK-ja tash do ta ketë mundësinë të ankohet në CAS në Lozanë ndaj këtij vendimi.

Pas vendimit të UEFA-s, Kosova do të përfundojë e dyta në



tabelën e Grupit 2 të Ligës C në Ligën e Kombeve me 12 pikë, prej tyre 4 fitore e 2 humbje, ndërsa të premtën do ta mësojë emrin e kundërshtarit të fazës së "play-off"-it.

### Vendimi i UEFA-s

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 50000 euro dhe të urdhërojë mbylljen e stadiumit të Federatës Rumune të Futbollit

gjatë (1) ndeshjes së ardhshme në të cilën Federata Rumune e Futbollit do të luajë si shoqatë mikpritëse, për sjelljen raciste dhe/ose diskriminuese të mbështetësve të saj (në lidhje me thirrjet ksenofobike antihungareze).

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 30000 euro për transmetimin e mesazheve provokuese politike të papërshtatshme për një ngjarje sportive.

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 9000 euro për hedhjen e sendeve.

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 4500 euro për ndezjen e fishekzjarrëve.

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 8000 euro për përdorimin e laserëve.

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 12500 euro për shkak të trazirës gjatë himnit kombëtar.

Të gjobisë Federatën Rumune të Futbollit me 14 mijë euro për

bllokimin e rrugëve publike.

Të paralajmërojë Federatën Rumune të Futbollit për sjelljen e pahijshme të ekipit të saj.

### Akuzat ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës

Refuzimi për të luajtur (tërheqje nga loja), Art. 27(1) DR dhe Art. 27(4)(a) DR në lidhje me Art. 25.01 Rregulloret e Ligës së Kombeve.

Sjellja e pahijshme e ekipit (kartonë të verdhë 5 lojtarë ose më shumë), Art. 15(4) DR

Të shpallet ndeshja e Ligës së Kombeve 2025 ndërmjet Federatës Rumune të Futbollit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës, e luajtur më 15 nëntor 2024, si e dorëzuar nga Federata e Futbollit të Kosovës (e cila për këtë arsye konsiderohet se e ka humbur ndeshjen 3:0) për përgjegjësinë që ndeshja nuk luhet plotësisht (siç parashikohet në nenin 25.01 Rregulloret e Ligës së Kombeve).

Të gjobisë Federatën e Futbollit të Kosovës me 6000 euro për sjellje të pahijshme të skuadrës së saj.

## Legjenda e Arsenalit emërohet trajner i Genoas

**GENOA, 20 NËNTOR** - Genoa ka konfirmuar emërimin e legjendës së Arsenalit, Patrick Vieira, trajner i ri i klubit. Skuadra nga Seria A që po kalon nëpër telashe të mëdha ka konfirmuar tani se ish-futbollisti i skuadrave të mëdha italiane do të jetë trajneri i tyre. Genoa ka thënë se Vieira do ta marrë drejtimin e seancës së tij të parë stërvitore të mërkurën pasdite pas nënshkrimit të kontratës së tij në selinë e klubit në Villa Rostan. Grifone ka shkarkuar papritmas trajnerin e tyre, Alberto Gilardino, të martën, vetëm pesë ditë përpara një ndeshje kyçe të Serisë A kundër rivalit të drejtpërdrejtë Cagliari. Ish-reprezentuesi francez Patrick



Vieira e ka filluar karrierën e tij si trajner në Manchester City me Elite Development Squad dhe më pas ka kaluar në New York City FC të lidhur me City Group.

Ai, gjithashtu, ka drejtuar Crystal Palace në Premierligë, plus Nice dhe Strasburg në

Ligën 1 të Francës. Vieira ka përvojë futbollit në Serinë A, pasi ka luajtur për Milanin, Juventusin dhe Interin. Ai ka bërë 100 paraqitje në ligën më të mirë të Italisë dhe ka shënuar 11 gola, me periudhën më të ndritur të tij te zikaltrit.

## Nadali përshëndetet me tenisin

**MALAGA, 20 NËNTOR** - Rafael Nadal, legjenda e tenisit, ka luajtur ndeshjen e tij të fundit profesionale, duke humbur 6-4, 6-4 ndaj Boticvan de Zandschulp në çerekfinalet e Kupës Davis. Nadali, i cili ka njoftuar tërheqjen nga sporti pas këtij turneu, ka fituar 92

tituj në karrierë dhe 22 Grand Slam, përfshirë 14 tituj të French Open. Ai, po ashtu, do të kujtohet për rivalitetin epik me Roger Federerin. Mirëpo, pas ndeshjes së tij të fundit, Nadali ka thënë se dëshironte të kujtohej si një "njeri i mirë nga një fshat i vogël në Mallorca".



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Mineral” L.L.C. Çikatovë e Vjetër, Glllogoc në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e prodhimit të betonit Linja 1 dhe Lindja 2 në Miradi të Epërme, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2025 në ora 11:00 në Shkollën Filllore e Mesme e Ulët “Vëllezrit Frashëri”, në Fushë Kosovë do të organizohet debat publik nga Kompania “Mineral” L.L.C. Çikatovë e Vjetër, Glllogoc në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Mineral” L.L.C. Çikatovë e Vjetër, Glllogoc për bazën e prodhimit të betonit Linja 1 dhe Lindja 2 në Miradi të Epërme, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnk.komente@rks-gov.net](mailto:vnk.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Alberti-9” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Alber Dërmaku, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810051475 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Alberti-9” D.O.O. Gnjilane, sa vlasnikom Alber Dërmaku, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810051475 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Alberti-9” L.L.C. with headquarters in Gjilan, with owner Albert Dërmaku, has come to the decision to quit its business: 810051475 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Alija Grup” SH.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811581596 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Alija Grup” D.O.O. Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811581596 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Alija Grup” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811581596 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Selim Zyberi” B.I. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810205270 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti “Selim Zyberi” B.I. Djakovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810205270 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that “Selim Zyberi” B.I. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 810205270 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës

Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova  
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik. Në bazë të nenit 20 pika 1.6 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr.04/L-150, nenit 23 pika 1.6 të Statutit të OIK-ut dhe mbështetur në Rregulloren Organizimi i Shërbimit Profesional Administrativ të OIK-ut, OIK shpallë këtë:

### KONKURS

Per këtë pozitë të punës:

#### I. Titulli i vendit të punës: Zyrtar administrativ për anëtarësim, licencim dhe rilicencim:

Norma e punës: Orar i plotë (40 orë punë në javë)  
Kontrata: Sipas legjislativës në fuqi  
Raportoni: Kryetari të OIK-ut  
Nr. i zyrtarëve: Një (1) Pozitë.

#### Përshkrimi i detyrave të punës:

- Pranimi i kërkesave për anëtarësim, regjistrim, licencim dhe rilicencim;
- Organizimi i takimeve të Komisioneve të lëvizjeve të ndryshme për shqyrtim të aplikacioneve të ndryshme;
- Mbajtja e Procesverbaleve;
- Përgaditja dhe procedimi i licencave dhe akteve tjera pas aprovimit të komisionit;
- Regjistrimi i fletëpagesave ( të hyrave) të taksave për shërbimet e kryera;
- Barazimet me raportet e bankave;
- Lëshimi i akteve dhe dokumenteve tjera sipas kërkesës së anëtarëve të odës të cilët janë nën përgjegjësi të Zyrës;

#### Shkollimi i kërkuar:

- ✓ Diploma e Fakultetit
- ✓ 1 (një) vit përvojë pune.

#### Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- ✓ Diploma e Fakultetit Universitar
- ✓ Dokumenti i identifikimit (Letërnjoftimi) kopje
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës.

#### Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- ✓ Të ketë shkathësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë,
- ✓ Të ketë njohuri të gjuhëve zyrtare në përdorim;
- ✓ Njohja e punës me kompjuter është e domosdoshme.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, si dhe të ketë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Data e mbylljes së konkursit: 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren, plotësohet, dhe dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00-14:00 në zyrat e OIK-ut.

Adresa: Rruga "Holger Pedersen" mbrapa QKUK-së kompleksi banesor Vëllëzërit Asllani.

Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

Kandidatët të cilët aplikojnë, të ofrojnë dëshmitë sipas konkursit të shpallur, për ndryshe kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të thirren për intervistim.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Saranda Gjonaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e Gjimanzit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinierit i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



# TRADITË QË NGA

# 1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

